



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.629/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Adnan Konushevci dhe Afijete Sada Glllogjani anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, e paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – thyerja e heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa A.nr.629/2021 e datës 17.10.2021, e parastruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ndërsa subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 1,200.00 (një mijë e dyqind) euro, në emër të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – Thyerja e heshtjes zgjedhore.

II. DETYROHET subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, që gjobën e shqiptuar si në pikën - I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

PZAP-i me datën 17 tetor 2021 ka pranuar ankesën A.nr.629/2021, të parastruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendohet se në ditën e zgjedhjeve, datë 17.10.2021 në ora 13:12 kandidati për Kuvend Komunal nga Lëvizja Vetëvendosje – Adem Breznica ka dërguar SMS përmes të cilit ka bërë thirrje për votim duke thënë shprehimisht “Dil voto – 17 tetori është sot”, çka paraqet shkelje të rëndë të nenit 36, par. 1, pika 1) e LZP-së dhe të rregullave zgjedhore si dhe

Gjithashtu, parashtruesi i ankesës si provë në ankesën e tij ka bashkangjitur edhe dy fotografi.

Paneli, në kuptim të nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e informoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, lidhur me ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës.

Në përgjigje në ankesë të datës 17.10.2021, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, i ka kundërshtuar pretendimet e ankuesit duke theksuar se kjo metodë përmes Viber në të cilën mbështetet parashtruesja e ankesës është metodë që nuk vërteton saktë pronarin e numrit telefonik. Gjithashtu thekson se parashtruesi i ankesës nuk e ka materializuar me prova ankesën dhe në mungesë të provave e njëjta duhet të refuzohet si e pabazuar dhe nuk plotëson kushtet e parapara për trajtimin e kësaj ankesë e aq më pak për shqiptimin e ndonjë sanksioni.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave, e posaçërisht nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje respektivisht kandidati për kuvend komunal i këtij subjektit, Adem Breznica përmes SMS në Viber ka bërë thirrje tek qytetarët e Kosovës që të dilet të votohet e ku rrjedhimisht në profilin e tij në Viber shihet edhe fotoja e tij me numër të subjektit politik, slloganin e tyre si dhe numri i të njëjtit për asamblenë komunale, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) e LZP-së, e cila përcakton *“Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrës te Votimit për hedhjen e votës, e deri ne mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidateve te tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje nuk ka dërguar asnjë SMS tek qytetarët dhe se nuk mund të vërtetohet se i numri telefonik është pronë e kandidatit Adem Breznica, paneli e vlerësoi si jo relevante, për faktin se mesazhet janë dërguar në emër dhe për llogari të kandidatit në fjalë, ku nga fotot e bashkangjitura në ankesë shihet çartë se nga profili në Viber i SMS-it të dërguar paraqitet fotoja e kandidatit Adem Breznica, me numër të subjektit politik, slloganin e tyre si dhe numrin e të njëjtit për asamblenë komunale, veprime këto që janë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkëljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkëljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që koinsiston në faktin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkëljet e rregullave dhe Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me Rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore.

Paneli vlerësoi se kjo mënyrë e të bërit fushatë qoftë drejtpërdrejt nga subjekti apo në emër dhe për llogari të subjektit nga mbështetësit e subjektit, cenon lirinë e përcaktimit të qytetarit duke e shqetësuar dhe duke tentuar që të ndikoj tek i njëjti për përcaktimin e tij për të votuar.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.629/2021 më datën 18.10.2021

Kryesuese e Panelit



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së,